

VENDIM
Nr.430, datë 22.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË SË PËRHERSHME TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PRANË SELISË SË NATO-S, BRUKSEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i dytë i pikës 2, shfuqizohet.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Në Përfaqësinë e Përherëshme të Republikës së Shqipërisë pranë selisë së NATO-s funksionon përfaqësia ushtarake, e cila përbëhet nga:

- | | |
|---|-----------------|
| - Përfaqësues ushtarak në NATO | gjeneral major; |
| - Zëvendëspërfaqësues | kolonel; |
| - Oficer shtabi për inteligjencën | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për operacionet e stërvitjen | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për logjistikën | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për planifikimin | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për komunikim/standardizim | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për komitetet politiko-ushtarake të NATO-s dhe koordinimin me BE-në | nënkolonel; |
| - Oficer shtabi për mbrojtjen ajrore | nënkolonel; |
| - Specialist për administrim/financë/protokoll | major; |
| - Nënoficer për administrim/sekretar/operator | kapter; |
| - Nënoficer për regjistrin, rrjetin e klasifikuar | kapter; |
| - Shofer/adjutant | kapter. |

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha